

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJËGJËSI TË KUFIZUAR
“ArchiTech“ shpk

Në Tiranë, sot më datë 09.04.2021, ne të poshtëshënuarit:

- 1- **Rezart Struga**, i datëlindjes 27.04.1988, indur në Tiranë dhe banues në Tiranë, identifikuar me dokument identifikimi: Letërnjoftim ID, me numër personal I80427073G,
- 2- **Gerti Struga**, i datëlindjes 17.03.1992, në Tiranë dhe banues në Tiranë, identifikuar me dokument identifikimi: Letërnjoftim ID, me numër personal J20317059F

me cilësinë e “ortakëve themelues” deklarojmë se me vullnet të lirë të plotë, mbështetur në ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008, “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007 “ Për Regjistrimin e Biznesit“, i ndryshuar, krijojmë shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar, “ArchiTech“ shpk,

Neni 1
Emri, Forma

Shoqëria do të ketë emrin ArchiTech”, dhe formë ligjore: “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).

Neni 2
Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik, pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Neni 3
Selia

Shoqëria e ka selinë në adresë: Rruga Vaso Pasha, Kompleksi Mangalem 21 , Shkalla 6 Ap.0687

Neni 4
Objekti i veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

Studio Projektimi, Mbikqyrje, Kolaudimi dhe Auditimi si dhe ofrimi i shërbimeve dhe konsulencave profesionale lidhur me fushat perkatese. Projektme dhe zbatime te ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore. Projektme dhe zbatime interieresh. Studime, planifikime, vleresime dhe projektme dhe zbatime urbanistike. Projektme dhe zbatime peisazhi dhe sistemimi. Studime dhe projektme dhe zbatime produktesh; Studime, projektme, dizenjime dhe zbatime per market. Studime, projektme dhe zbatime te inxhinierise se ndertimit, inxhinierise elektrike dhe inxhinierise hidromekanike. Projektme konstruktive dhe supervizim punimesh Studime e



projektme dhe zbatime hidrogjeologjike dhe gjeologjike; Projektim dhe zbatime fotogrametrik, hartografik, topografik; Studime ne fushen e auditimit ne ndertesa, ne industri, ne transport, ne menaxhimin e energjise. Studime fizibiliteti; Projektme dhe zbatime rruges, urash, porte turistike; Projektme dhe zbatime linjash dhe sistemesh se prodhimit dhe shperndarjes se energjise elektrike, projektim ujesjelles, kanalizime, vepra ujitje, kullimi, impiante vaditese, diga, etj; Restaurime dhe konsulenca per sherbimet e me siperme; Tregetim mallrash brenda dhe jashte vendit; Per te realizuar objektin dhe qellimin e saj, Shoqeria mund te ndermarre dhe zhvilloje cdo lloj aktiviteti tjetër te lejuar nga ligji vetem ose ne bashkepunim me pale te treta nepermjet nenkontraktimit, qofte ky aktivitet tregtar, juridik, financiar, promocional, etj qe e vlereson te dobishme.

Neni 5
Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj pa afat.

Neni 6
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i nënshkruar dhe i shlyer i shoqërisë është 100 lekë, i ndarë në dy kuota, i cili zotërohet si më poshtë:

Rezart Struga, zotëron 1 kuotë me vlerë 60 lekë, e cila përbën 60 % të kapitalit të shoqërisë

Gerti Struga, zotëron 1 kuotë me vlerë 40 lekë, e cila përbën 40% të kapitalit të shoqërisë

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajshme/të paluajshme apo të drejta)

Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.


Neni 7
Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombetare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit".



Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Neni 8
Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë, për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 9
Administrimi

Administratorë të shoqërisë janë:

- Gerti Struga, i datëlindjes 17/03/1992, indur në Tiranë dhe banues në Tiranë, identifikuar me dokument identifikimi: Letërnjoftim ID, me numër personalJ 20317059F, emëruar ne këtë detyrë për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripërritje.

Neni 10
Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 11




Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 kopje, në gjuhën shqipe, me përmbajtje dhe vlera te njëjta juridike.

Akti i mësipërm pasi miratohet në parim dhe nën per nen nga Ortakët themelues të shoqërisë tregtare "Architech" shpk, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen origjinale.

ORTAKËT THEMELUES

Rezart Struga


Gerti Struga

